



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut  
Opština Kaçanik  
Municipal Kaçanik

01. Nr. 16-24231/16  
Kaçanik, 26.07.2016



Në bazë të nenit 12, 14, 17 lidhur me nenin 18.1(a) të Ligjit Nr. 03/L-040- Për Vetëqeverisjen Lokale( Gazeta Zyrtare nr. 28/2008 e datës 4 qershor 2008), të nenit 4 paragrafi 2.4 dhe 3.6 të Ligjit 03/L-139 -Për Shpronësimin e pronës së paluajtshme, si dhe Ligjit Nr. 03/L-205 të datës 28.10.2010 për Ndryshim Plotësimin e Ligjit 03/L-139 - Për shpronësimin e pronës së paluajtshme ( Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 91), të nenit 6 të Statutit të Komunës, Kuvendi i Komunës Kaçanik, në mbledhjen e mbajtur me, 26 Korrik 2016, mori këtë :

#### V E N D I M

#### **PËR SHPALLJEN E INTERESIT TË PËRGJITHSHËM PUBLIK PATUNDSHMËRINË NGA PARCELA KADASTRALE NR- 00728-2 NË Z.K. KAÇANIK I VJETËR - PËR NDËRTIMIN E QENDRËS SË MJEKËSISË FAMILJARE NË KAÇANIK TË VJETËR**

Me këtë Vendim, Shpallet me interes të përgjithshëm publik –për interesa ë komunës së Kaçanikut, Patundshmëria në parcelën kadastrale Nr.00728-2, me sipërfaqe prej 0.12.00 ha. Z.K Kaçanik i Vjetër, në emër të P.Sh Ndërmarrja Tregtare “Sharr” në Kaçanik.

1. Patundshmëria në parcelën kadastrale si në pikën 1 të këtij Vendimi, është e paraparë të destinohet për interesin e Komunës Kaçanik, për – Ndërtimin e Qendrës së Mjekësisë Familjare në Kaçanik të Vjetër.
2. Ndërtimi i Qendrës së Mjekësisë Familjare në Kaçanik të Vjetër është në interesit të përgjithshëm publik, dhe lidhur me parcelën me numër të sipërshënuar si në pikën 1. të këtij Vendimi, mund të filloj procedura e Shpronësimit, dhe në asnjë mënyrë kjo pronë nuk mund të tjetërsohen dhe as t'i ndërrohet destinimi, pa Vendimin e Kuvendit të Komunës Kaçanik.
3. Obligohet Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit, sipas dispozitave ligjore të ligjeve në fuqi, t'i zhvilloj procedurat e nevojshme të shpronësimit të patundshmërisë së përcaktuar si në pikën 1. të këtij Vendimi.



4. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Kryetari i Komunës dhe drejtorja për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit.
5. Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të MAPL si dhe pas publikimit në faqen zyrtare të komunës.

### Arsyetim

Kryetari i Komunës Kaçanik, i është drejtuar Kuvendit të Komunës Kaçanik, me Propozim Vendim 01Nr. 16-24231/16 prej datës 20.07.2016 për shpalljen e interesit të përgjithshëm publik, të patundshmërisë së përcaktuar si në dispozitiv të këtij Vendimi. Kuvendi i Komunës Kaçanik në mbledhjen e vet të mbajtur me datë 26.07.2016, shqyrtoj Propozim Vendimin me numër të sipërshënuar, dhe duke u bazuar në arsyetimin e dhënë nga Shërbimi Profesional- Drejtorja për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit, se kjo pronë është e përcaktuar me Vendimin mbi Planin Zhvillimor Urban të Kaçanikut 01-Nr.5300/2010, Ndërtimi i Qendrës së Mjekësisë Familjare në Kaçanik të Vjetër, është me interes të veçantë publik për qytetarët e Komunës së Kaçanikut dhe nevojë banorët e kësaj ane, por për shkaqe procedurale me AKP duhet që të shpallet interesi publik ajo patundshmëri, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Kryesuesi i Kuvendit  
Xhelal Gashi

